



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datën **08.04.2014** Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në SP për kontroll kufitare-Deve Bair-Kriva Pallankë, ndërsa vizita u realizua në bashkëpunim me bashkëpunëtorë të jashtëm nga Shoqata maqedonase e juristëve të ri.

MPN realizoi **vizitë të paparalajmëruar** në stacionin policor për kontroll kufitare **Deve Bair** me qëllim të vërtetimit të gjendjeve dhe kushteve në vendet ku personat privohen nga liria dhe lidhur me trajtimin e tyre. Qëllimi i vizitës është përcaktuar konform Protokollit Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ definohet se qëllimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat janë privuar nga liria është identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose llojit tjetër të trajtimit brutal, johuman, nënçmues ose ndëshkues.

Vizita e Stacionit Policor për kalim kufitar-Deve Bair u realizua në mënyrë që fillimisht u realizua bisedë me kryeshefin e SP, ndërsa mëtej ekipi i MPN-së, bëri inspektim në ambientet e stacionit policor, si dhe inspektim në evidencën për personat e privuar nga liria. Gjatë kohës së vizitës në stacionin policor nuk kishte persona të privuar nga liria.

SP për kontroll kufitare **Deve Bair** nuk është emëruar konform Aktvendimit për stacion policor ku ndalen persona të privuar nga liria, prandaj në të njëjtin nuk ka ambient të veçant ekskluzivisht për nevoja të tilla. Duke marrë parasysh kompetencat të cilat i ka, ky stacion mund të privojë nga liria persona të cilët kërkohen, përkatësisht për të cilët është lëshuar fletarrest ose bëhet fjalë për persona të cilët në mënyrë ilegale kanë hyrë në shtetin. Personat të cilët privohen nga liria përkohësisht qëndrojnë në ambient i cili shfrytëzohet edhe për mbledhje, udhëheqje të bisedave informative etj. Ky ambient për momentin përdoret nëmestjerash edhe për ruajtjen e pajisjes teknike edhe si arkiv, gjë që e bën jopërkatës për ndalim të përkohshëm përkatësisht afatshkurtë të personave.

Vendkalimi kufitar nuk disponon me ambient të veçant për bastisje/kontroll të personave të privuar. MPN konstatoi se SP për kontroll kufitare Deve Bair si ambient të veçant për azilkërkues e shfrytëzon të njëjtin ambient i cili shfrytëzohet për personat e ndalur përkohësisht, ndërkaq konform informatave të kryeshefit deri më tani nuk ka pasur kërkesa të paraqitura për azil në këtë stacion. Në hyrje të Stacionit Policor në vend të dukshëm ishin theksuar informatat të cilat kanë të bëjnë me të drejtat të cilat i ka një person gjatë privimit të tij nga liria, Kodi policor i etikës, si dhe Rregullat për paraqitjen e personit zyrtar i cili i tejkalon kompetencat e tij dhe në mënyrë jopërkatëse sillen në vendin e punës.

Nga inspektimi në evidencën u konstatua se SP për kontroll kufitare Deve Bair udhëheq dokumente në mënyrë të rregullt, me ç'rast u bë inspektim në Regjistrin për ngjarje ditore, Regjistrin për persona të privuar, Regjistrin për persona të privuar nga liria dhe persona të ndalur dhe Regjistrin për sende të sekuestruara përkohësisht, ndërsa sipas zgjedhjes së rastësishme u kontrolluan katër dosarë individual. Në përgjithsi të gjithë

regjistrat udhëhiqen në mënyrë të rregullt nga fakti se të gjitha kolonat janë të plotësuara në mënyrë të qartë dhe të njëjtat janë të lexueshme.

Mekasnizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçant për vizitën e realizuar në të cilin janë konstatuar gjendje pozitive dhe negative dhe janë dhënë rekomandime përkatëse për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për kryeshefin e SP KK-Deve Bair.